

# Përkrahje për aplikantët

## 12 hapa për aplikim të suksesshëm

**KOSOVË: Fuqizimi i qeverisjes së mirë,  
transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve  
qeveritare - FCO CSSF**

**Versioni 1.0**

## 12 hapa për një aplikim të suksesshëm

Të jesh kandidati më i mirë në vend ka pak vlerë nëse nuk arrin në fazën e intervistave për ta demonstruar këtë. Aplikimi është rruga për të arritur në intervistë. Përkujdesja që kjo të bëhet mirë gjithashtu do të ju ndihmojë të përgatiteni për procesin e intervistave.

Qëllimi juaj është që t'i përgjigjeni kriterëve të shpalljes në atë mënyrë që ja lehtëson komisionit t'i shohësh dëshmitë karshi kriterëve. Kur ka formular për aplikim, aty mundet (ose jo) të kërkohet nga ju që të paraqitni dëshmi specifike për secilin kriter. Kjo e bën aplikimin më të lehtë. Megjithatë, në shumë procese të përzgjedhjes ose nuk ka formular për aplikim, ose aplikacioni nuk liston në mënyrë specifike kriteret e shpalljes.

Ky udhëzues ju ndihmon ta strukturoni aplikacionin tuaj në atë mënyrë që nënkupton se ju do ta merrni kontrollin për t'u siguruar që të gjitha dëshmitë për të gjitha kriteret të jenë të pranishme dhe të paraqitura mirë. Udhëzuesi është i paraqitur në format që mund ta përdorni si listë kontrolluese.

Hapi	Veprimi	✓
1	<b>Filloni të përgatiteni herët</b> Ndani mjaft kohë për të përgatitur të gjitha dokumentet tuaja dhe aplikacionin. Kështu do të mund të kontrolloni se a i keni të gjitha. Nëse e lini këtë për ditët e fundit për aplikim gjasat për të harruar diçka do të jenë më të mëdha. Çdo herë e më shpesh në konkursat e shpallura ceket që dokumentacioni i pakompletuar do të rezultojë me eliminim të aplikantëve në listën e ngushtë. Pavarësisht se a ceket kjo në konkurs apo jo, përgjegjësia është e juaja që të paraqitni të gjitha që kërkohen me aplikacionin tuaj dhe para datës së mbylljes së konkursit. Gabimet e thjeshta ndikojnë që edhe kandidatët e mirë të mos hyjnë në listë të ngushtë p.sh. certifikata që kandidati nuk është nën hetim, është e vjetër.	
2	<b>Lexojeni shpalljen me kujdes</b> Tingëllon si shumë e qartë, megjithatë shumë kandidatë nuk i lexojnë kërkesat e konkursit me vëmendjen e duhur. Lexoni me vëmendje kriteret - kjo është ajo që kërkohet ta përmbushni, demonstroi dhe më e rëndësishmja ta dëshmoni.	
3	<b>Krijoni një listë me kriterë</b> Kjo mund të duket që merr kohë dhe si gjë e lodhshme. Megjithatë, do të ju ndihmojë më vonë kur të rishikoni se çka keni përgatitur. Në këtë fazë mund ta bëni edhe një vetë-vlerësim duke shqyrtuar tri pyetje:  <ol style="list-style-type: none"><li>1. A i përmbushi unë kriteret e kërkuara?</li><li>2. A mund ta demonstroj këtë në dokumentacionin për aplikim (aplikacioni/CV etj.)?</li><li>3. A kam dëshmi të dokumentuara për të vërtetuar që i përmbushi kriteret?</li></ol>	
4	<b>Diplomat</b> Nëse konkursi kërkon që të keni diplomë - a e keni diplomën përkatëse? Disa konkurse kërkojnë që të keni diplomë relevante për sektorin apo punën e institucionit. Nëse mendoni se diploma juaj është relevante, por që të tjerët mund të mos e shohin menjëherë pse është relevante, atëherë përkujdesuni ta shpjegoni relevancën e saj në aplikacionin tuaj, CV-në apo	

	në Letrën e Motivimit - apo edhe më mirë, në të tri këto dokumente ku kërkohet.	
<b>5</b>	<b>Kohëzgjatja e studimeve</b> Në shumë raste kërkohet së paku diplomë nga studimet katërvjeçare. Nëse diploma juaj është nga studimet trevjeçare atëherë kërkohet që të keni edhe diplomë shtesë (p.sh. Master) dhe të paraqitni certifikatat për to.	
<b>6</b>	<b>Diplomat jashtë Kosovës</b> Nëse ndonjëra nga diplomat tuaja janë marrë jashtë Kosovës atëherë duhet t'i nostrifikoni ato. Nostrifikimi i mundëson Komisionit që ta llogaritë atë kualifikim si të vlefshëm në kontekst të Kosovës. Nëse diploma e tillë nuk është e nostrifikuar me gjasë nuk do të pranohet. Diplomën tuaj nga studimet jashtë vendit mund ta nostrifikoni nga Autoriteti përkatës i Arsimit në Kosovë.	
<b>7</b>	<b>Diplomat tjera</b> Nëse keni diploma tjera, p.sh. master, PhD ose jeni profesor. Mos supozoni që kjo dëshmi e zëvendëson dëshminë për diplomë të studimeve bazike. Edhe pse këto nuk mund të arrihen pa diplomë të studimeve bazike, prapë kërkohen të gjitha certifikatat e studimeve. Data e diplomimit tuaj përdoret për të llogaritur përvojën tuaj të punës, pasi që përvoja juaj e punës duhet të jetë pas kësaj date.	
<b>8</b>	<b>Kohëzgjatja e përvojës menaxheriale (drejtuese) dhe profesionale</b> Zakonisht në konkurse kërkohen 5 vite përvojë në menaxhim apo në menaxhim të lartë. Nganjëherë edhe 8 vite përvojë profesionale.  Pavarësisht afateve kohore, ta keni parasysh që përvoja e juaj menaxheriale dhe/ose profesionale do të llogaritet vetëm pas diplomimit tuaj (apo diplomës master për ta që kanë kryer studime trevjeçare). Duhet t'i llogaritni vitet, muajt dhe ditët kur keni qenë në pozita që përmbushin këto kritere. Nëse nuk i keni vitet e kërkuara të përvojës atëherë nuk mund të aplikoni. Aty ku i keni, kujdesuni që ta shpjegoni këtë plotësisht dhe qartësisht.  Paraqitni periudhat kohore qartazi që anëtarët e Komisionit të mund ta shohin këtë menjëherë. Tregoni datat e plota të fillimit dhe mbarimit për secilën pozitë (përfshini ditën, muajin dhe vitin). Shënoni kohëzgjatjen e plotë në çdo pozitë në vite, muaj dhe ditë; dhe këto do të kontrollohen.	
<b>9</b>	<b>Dëshmi për përvojën e punës</b>  Sigurohuni që të gjitha datat që i paraqitni në aplikacionin tuaj, në CV dhe dokumentet tjera të përputhen tërësisht. Aty ku ka mospërputhje në data Komisioni mund t'i referohet dëshmive të punësimit tuaj në vend të asaj që keni pohuar në CV-në tuaj.  Dëshmi e punësimit mund të jetë një letër zyrtare nga kompania ose institucioni p.sh. kontrata e punësimit. Letrat personale nga njerëzit me të cilët keni punuar, qoftë edhe nga Drejtori juaj, nuk pranohen si dëshmi. Veç kësaj, <b>duhet të siguroheni</b> që dëshmitë t'i vërtetoni përmes dokumenteve të Trustit Pensional. Edhe këto dëshmi duhet t'i siguronit dhe paraqitni. Mungesa e këtyre dëshmive do të rezultojë me refuzim të	

	<p>aplikacionit tuaj.</p> <p>Periudhat e punësimit për të cilat nuk keni dëshmi nuk do të llogariten dhe kjo mund të ndikojë në refuzim të aplikacionit tuaj p.sh. nëse për një pozitë nuk ka dëshmi (dhe ajo nuk llogaritet) dhe për shkak të kësaj nuk përmbushet numri i minimal i viteve të përvojës atëherë aplikacioni juaj mund të refuzohet.</p>	
<b>10</b>	<p><b>Niveli i dëshmime</b></p> <p>Shikoni se sa keni dëshmi për përvojën që përmbushë, apo është afër, nivelit për pozitën për të cilën aplikoni. Dhe edhe pse aplikacioni juaj nuk do të refuzohet domosdoshmërisht për shkak të nivelit të përvojës tuaj, gatishmëria juaj për këtë pozitë do të testohet gjatë intervistës. Duhet të vendosni nëse jeni aplikant i besueshëm për pozitën duke pasur parasysh përvojën e mëhershme - p.sh. nëse aplikoni për pozitën Drejtor, a keni përvojë në menaxhim të lartë, që ju bën të përgatitur për pozitën e Drejtorit?</p>	
<b>11</b>	<p><b>Krijoni një listë të dokumenteve të kërkuara</b></p> <p>Bëni një listë të të gjitha dokumenteve që kërkohen në konkurs dhe kontrolloni që i keni siguruar dhe përfshirë të gjitha. Dijeni që çdo dokument që mungon mund të ndikojë që aplikacioni juaj të refuzohet. Nganjëherë konkurset theksojnë që dokumentacioni i pakompletuar rezulton me refuzim të aplikacionit - e nganjëherë jo. Megjithatë, gjithmonë është përgjegjësi e aplikantit që ta kompletoj dokumentacionin e nevojshëm. Pavarësisht se a i përmend konkursi apo ajo pasojat e moskompletimit të dokumenteve, aplikacioni juaj mund të refuzohet si rezultat i mungesës së dokumenteve.</p> <p>Shikoni me vëmendje se brenda cilave data duhet të jetë e lëshuar certifikata që kandidati nuk është nën hetime. Në disa raste kjo kërkohet të jetë lëshuar pas datës së shpalljes së konkursit. Në raste tjera kjo nuk theksohet. Kur nuk theksohet kujdesuni që certifikata juaj të jetë më e re se 6 muaj.</p>	
<b>12</b>	<p><b>Dorëzoni aplikacionin dhe dokumentet tuaja brenda afatit</b></p> <p>Aplikacionin duhet ta dorëzoni në zarf të mbyllur dhe ta nënshkruani konfirmimin e dorëzimit të tij. Nëse aplikacioni dhe dokumentet tuaja dorëzohen pas afatit për aplikim ato nuk do të pranohen.</p>	

Tani që e keni plotësuar aplikacionin tuaj hollësisht dhe sistematikisht, ja keni dhënë vetës rastin më të mirë për sukses. Tani kujdesuni që ta dorëzoni aplikacionin tuaj para datës së fundit për aplikim dhe keni besim që i keni bërë të gjitha që mundeni.